STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 25 korrik 2013

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON SIGURIMIN E $200 MILION DOLLARËVE PËR TË PLOTËSUAR NEVOJAT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE DHE SOCIALE SI REZULTAT I SUPER STUHISË SANDY

Dollarët e qeverisë federale në dispozicion për të mbuluar shpenzimet dhe për të riparuar dhe rindërtuar institucionet

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se $200 milion dollarë janë vënë në dispozicion për të financuar kërkesat e siguruesve të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale si dhe organizatave të tjera të komunitetit pas impaktit të super stuhisë Sandy. Fondet janë siguruar nga Granti Bllok për Shërbimet Sociale Suplementare për Super Stuhinë Sandy (Superstorm Sandy Supplemental Social Services Block Grant) për të mbuluar shpenzimet e domosdoshme si rezultat i stuhisë, përfshi shërbimet sociale, shëndetësore, ato të shërbimit mental për njerëzit si dhe për riparimin, rinovimin dhe rindërtimin e institucioneve shëndetësore, institucioneve të higjienës mentale, institucioneve të kujdesit për fëmijët si dhe institucioneve të tjera të shërbimeve sociale.

"Gjatë dhe pas super stuhisë Sandy, siguruesit e shërbimeve shëndetësore dhe sociale të shtetit të Nju Jorkut, kryen punë shumë të rëndësishme për njujorkezët dhe ata vazhdojnë të jenë burim jetësor për komunitetet që po rimëkëmben nga stuhia", tha guvernatori Cuomo. "Këto organizata u shërbejnë nevojave të shumicës së banorëve vulnerabël të shtetit, përfshi të moshuarve, fëmijëve dhe familjeve me të ardhura të pakta, si dhe bizneseve që kanë pësuar humbje financiare dhe dëme strukturore nga stuhia. Ky fond do të sigurojë mbështetjen e nevojshme me qëllim që të vazhdohet ndihma për komunitetin dhe unë i nxit të dëmtuarit nga stuhia të aplikojnë për asistencë".

Për të plotësuar nevojat e këtyre siguruese të rëndësishëm të shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe popullsisë të cilës i shërbejnë ata, Nju Jorku do të shpërndajë $200 milion dollarë nga fondi federal Sandy SSBG nëpërmjet kërkesës publike dhe transparente për propozime. Aplikantët mund të kërkojnë fonde për:

- Koston e parimbursuar të riparimit, rindërtimit dhe renovimit të institucioneve të kujdesit për fëmijët, institucioneve shëndetësore dhe të shëndetit mental, qendrave të të moshuarve dhe institucioneve të ngjashme si dhe institucioneve të tjera të shërbimeve sociale si përgjigje ndaj super stuhisë Sandy, përfshi masat për t'i bërë më të qëndrueshme këto institucione ndaj ngjarjeve nga moti i keq në të ardhmen.

- Rimbursimin e kostos për kujdesin për fëmijët, shëndetësinë, kujdesin shëndetësor mental, shëndetin e sjelljes, punësimin, si dhe për shërbimet e tjera direkte si dhe kostot për materialet e humbura dhe të dëmtuara të shkaktuara nga super stuhia Sandy.
- Rimbursimin e bankave ushqimore (food banks), depove ushqimore (food pantries) si dhe organizatave të ngjashme dhe agjencive publike për kostot e krijuara si rezultat i rritjes së kërkesës për ndihma ushqimore gjatë dhe pas super stuhisë Sandy.
- Forcimin e kujdesit për fëmijët, ushqimin, shëndetësinë, shëndetin mendor, punësimin, koordinimin ligjor, fokusuar te të moshuarit, koordinimin vullnetar, menaxhimin e çështjeve dhe shërbimeve të tjera direkte për të plotësuar nevojat e vazhdueshme të njujorkezëve të prekur nga Sandy.
- Pajisjet dhe materialet që nevojiten për të rritur shërbimet në zonat e goditura nga Sandy.
- Kostot e tjera të shërbimeve shëndetësore dhe sociale që u bënë gjatë Sandy-it si dhe nevojat në vazhdim të institucioneve dhe siguruesve të tjerë të shërbimeve.

Presidenti i Shoqatës së Spitaleve të Metropolit të Nju Jorkut (Greater New York Hospital Association) Kenneth E. Raske tha, "Ne përshëndesim guvernatorin Cuomo që na ka siguruar këto fond me rëndësi kritike për ne dhe që ua ka vënë në dispozicion spitaleve dhe shtëpive të të moshuarve. Ato do të ndihmojnë komunitetin e kujdesit shëndetësor të Nju Jorkut të riparojë dhe rindërtojë institucionet që u dëmtuan apo u shkatërruan nga Sandy dhe për të siguruar qëndresën e tyre në rast të ngjarjeve të motit të egër në të ardhmen".

Presidenti i shoqatës së Bankës Ushqimore të shtetit të Nju Jorkut (Food Bank Association of New York State) Mark Quandt tha, "Bankat ushqimore dhe depot e ushqimeve siguruan asistencë jetësore për njujorkezët gjatë dhe pas Sandy-it. Unë i jam mirënjohës guvernatorit që u siguroi këto fonde për të vazhduar rolin e tyre në shërbim të njerëzve në nevojë".

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Shtetit të Nju Jorkut për Edukimin e Fëmijëve të Vegjël (New York State Association for the Education of Young Children) Kristen Kerr tha, "Kujdesi për fëmijët është një pjesë kritike për ekonominë e çdo komuniteti dhe shumë nga programet u shkatërruan nga super stuhia Sandy. Përfshirja nga ana e guvernatorit e kujdesit shëndetësor në planin e Nju Jorkut për përdorimin e fondeve suplementare SSBG, do të sigurojë ndihmën kaq të dëshiruar për të siguruar që bizneset e vogla të jenë në gjendje të sigurojnë shërbimet e tyre esenciale në zonat e prekura".

Shteti i Nju Jorkut i paraqiti planin e fondeve Departamentit të Shërbimeve Njerëzore dhe Shëndetësore (Department of Health & Human Services) më 30 qershor dhe plani shtetëror u aprovua më 22 korrik. Siguruesit e kujdesit shëndetësor dhe të shërbimeve sociale mund të paraqesin aplikimet për fonde deri më 30 gusht 2013.

Informacionin për fondet në dispozicion si dhe linkun për aplikimin në internet do t'i gjeni në http://nysandyhelp.ny.gov/content/sandy-social-services-block-grant-ssbg-funding.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shteti i Nju Jorkut | Executive Chamber) | press.office@exec.ny.gov| 518.474.8418

Albanian